

VENDIM
Nr.888 , datë 22.12.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË
SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.185, datë 16.4.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë, (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për punonjësit ushtarakë të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe të drejtorive në varësi të saj, është përkatësisht sipas lidhjes nr.1 “Paga bazë sipas klasave për ushtarakët e shërbimit pyjor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Niveli më i ulët i pagës (Klasa I) bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, ndërsa niveli më i lartë (Drejtor drejtorie rajonale/drejtor drejtorie. Klasa XXIII) bëhet 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekë në muaj.

Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për çdo vit pune, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe punonjësit e drejtorive në varësi, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKE TË SHËRBIMIT
PYJOR

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	i	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	12000
6	VI	12300
7	VII	12600
8	VIII	12900
9	IX	13100
10	X	13900
11	XI	14400
12	XII	14800
13	XIII	15500
14	XIV	16000
15	XV	16300
16	XVI	16700
17	XVII	17000
18	XVIII	18000
19	XIX	19000
20	XX	20000
21	XXI	22000
22	XXII	24000
23	XXIII	28000